

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT,
FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE

RAPORTI VJETOR 2020

Pasqyra e lëndës

Misioni i AKAFPK-së.....	3
Organizimi.....	4
Kontakte	6
AKRONIME.....	7
PËRMBLEDHJE	8
Veprimtaritë kryesore të AKAFPK-së.....	8
Veprimtari në kuadrin e Task Forcës për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve	12
Zbatimi i projektit “EPALE National Support Services 2019-2020” /Erasmus+	12
Marrëveshja e Grantit 614329-EPP-1-2019-1-AL-EPPKA3-AL-AGENDA “National Coordinators for the Implementation of the EU Adult Learning Agenda”, në programin Erasmus+	13
Zbatimi i projektit “FORWORK – Fostering Opportunities of Refugee Eorkers”, Marrëveshja e Grantit nr. VS/2017/0446, në kuadrin e programit të Bashkimit Europian për punësimin dhe inovacionin social (EASI) ..	13
Veprimtari për rregullimin e praktikave profesionale të nxënësve/kursantëve në biznes	14
Problematikat	14
ANEKSE: VEPRIMTARITË E DETAJUARA SIPAS SEKTORËVE.....	16
ANEKS I Veprimtaria e Sektorit të Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale	16
ANEKS II VEPRIMTARIA E SEKTORIT TË SKELETKURRIKULAVE DHE STANDARDEVE TË TRAJNIMIT TË MËSUESVE NË AFP (SSTM)	23
ANEKS III SEKTORI I VLERËSIM-CERTIFIKIMIT TË NXËNËSVE & AKREDITIMIT TË OFRUESVE TË AFP-së	31
ANEKS IV SEKTORI I ADMINISTRATËS, FINANCËS DHE TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT	39

MISIONI I AKAFPK-SË

AKAFPK-ja ka objekt kryesor të veprimtarisë së saj krijimin e një sistemi unik të kualifikimeve profesionale, të njohura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe zbatimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në përmbushje të këtij misioni, Agjencia synon të arrijë objektivat e mëposhtme:

- Zhvillimin e AFP ne lidhje me nevojat e teknologjisë moderne, tregun e punës dhe zhvillimit social te vendit.
- Sigurimin e partneritetit social në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fazat e planifikimit, zhvillimit dhe zbatimit të programeve të AFP.
- Integrimin e arsimit, formimit dhe punës në këndvështrimin e të nxënit gjatë gjithë jetës.
- Zhvillimin e dimensionit evropian të AFP duke siguruar një transparencë të kualifikimeve dhe përafrimit te kompetencave me tregun e përbashkët evropian.
- Zhvillimin e instrumenteve për realizmin e politikave për zbatimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve
- Hartimin e instrumenteve për zbatimin e sistemit të sigurimit të cilësisë nga institucionet ofruese të AFP-së

Në përmbushje të misionit te saj, AKAFPK-ja kryen funksionet e mëposhtme:

- Harton dhe rishikon Listën Kombëtare të Profesioneve, Listën Kombëtare të Kualifikimeve Profesionale, nivelet dhe standardet përkatëse
- Harton dhe rishikon skelet-kurrikulat e kualifikimeve profesionale;
- Harton dhe rishikon standardet e trajnimit të mësimdhënësve të AFP-së;
- Përcakton parimet dhe kriteret e vlerësimit dhe certifikimit për kualifikimet profesionale;
- Akrediton institucionet e AFP për kualifikimet profesionale;
- Siguron që standardet e kompetencave të jenë në përputhje të plotë me praktikat më të mira ndërkombëtare, në veçanti me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve dhe Sistemin Evropian të Krediteve për AFP-në;
- Siguron bashkëveprimin e të gjithë aktorëve kontribuues të shoqërisë, në të gjitha nivelet dhe fazat e planifikimit, zhvillimit dhe zbatimit të programeve të AFP-së.

ORGANIZIMI

Organizimi i AKAFPK

Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve funksionon sipas strukturës dhe organikës të sanksionuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.321, datë 21.4.2011 "Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve" dhe urdhrin e Kryeministrit nr. 205 dt. 01.09.2006 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë". AKAFPK-së ka në organikë gjithsej 16 punonjës.

Struktura organizative e saj është si më poshtë:



Në këtë strukturë organizative, tri sektorët e parë konsiderohen si sektorët primarë në këtë institucion, ndërsa Sektori i Administratës, Financës dhe i Teknologjisë së Informacionit është konsideruar si sektor mbështetës.

Gjatë këtij viti në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 673, datë 16.10.2019 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve", grupi i punës përgatiti përgatiti "Rregulloren e brendshme për përzgjedhjen dhe shpërblimin e specialistëve të jashtëm me kontratë për realizimin e veprimtarive zhvillimore në fushën e arsimit dhe formimit profesional", si dhe përmirësoi dhe ridërgoi për miratim setin e dokumentacionit për të propozuar strukturën dhe organigramën e re e cila në thelb synon përmirësime të cilat mundësojnë përdorimin më me efektivitet dhe eficiencë të

burimeve ekzistuese, duke krijuar hapësirë për një racionalizim më të mirë të burimeve financiare me qëllim që t'i japë shtysë dhe mbështetje të fuqishme zhvillimit të AFP-së në Shqipëri, në përputhje me standardet evropiane.

Në tetor të vitit 2020, përmes Urdhrit të Kryeministrit është miratuar struktura dhe organika e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, dhe në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, institucioni është në proces ristrukturimi.

Në këtë kontekst, AKAFPK synon të arrijë (i) zhvillimin e AFP-së në lidhje me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimin social-ekonomik të vendit; (ii) sigurimin e partneritetit social në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fazat e planifikimit, zhvillimit dhe zbatimit të programeve të AFP-së; (iii) integrimin e arsimit, formimit dhe punës në këndvështrimin e të nxënës gjatë gjithë jetës; (iv) garantimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë të ofruesve publikë dhe jopublik si dhe (v) zhvillimin e dimensionit evropian të AFP-së, duke siguruar një transparencë të kualifikimeve dhe përafrimit të kompetencave me tregun e përbashkët evropian

KONTAKTE

Ejvis Gishti
Drejtore i AKAFPK-së Tel: 042230497
Email: Ejvis.Gishti@akafp.gov.al

Alqi Mustafai
Përgjegjës i Sektorit të Skelet-Kurrikulave dhe Standardeve të Trajnimit të Mësuesve të AFP-së
Tel: 042237087
Email: Alqi.Mustafai@akafp.gov.al

Teuta Braço
Përgjegjëse e Sektorit të Administratës, Financës dhe Teknologjisë së Informacionit
Tel: 042237087
Email: Teuta.Braco@akafp.gov.al

AKRONIME

AFP	Arsimi dhe Formimi Profesional
AKAFP	Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
AKP	Agjencia Kombëtare e Provimeve
ETF	European Training Foundation (Fondacioni Evropian i Trajnimeve)
DRFPP	Drejtori Rajonale e Formimit Profesional Publik
ISCED	International Standard for Classification in Education (Standardi Ndërkombëtar për Klasifikim në Arsim)
ILO	International Labor Organisation (Organizata Ndërkombëtare e Punës)
IoAFP	Institucione Ofruese të Arsimit dhe Formimit Profesional
ASCAP	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Para-universitar
LKP	Lista Kombëtare e Profesioneve
KEK	Korniza Evropiane e Kualifikimeve
KShK	Korniza Shqiptare e Kualifikimeve
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
SAFTI	Spektori i Administratës, Financës dhe Teknologjisë së Informacionit
SPKP	Spektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale
SSTM	Spektori i Skeletkurrikulave dhe Standardeve të Trajnimit të Mësuesve
SVCA	Spektori i Vlerësim-Certifikimit dhe Akreditimit të Ofruesve të AFP-së

PËRMBLEDHJE

Veprimtaritë kryesore të AKAFPK-së

Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve ka zbatuar veprimtaritë në përputhje me planin vjetor të punës të miratuar në vitin 2020 nga drejtori.

Veprimtaritë e AKAFPK-së janë zhvilluar në përputhje me prioritetet e zhvillimit të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, prioritetet të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019-2022, në objektivat e përcaktuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për rritjen e cilësisë në AFP, në parashikimet e PBA-së, si dhe në përshatje më kushte e situatës së jashtëzakonshme të krijuar nga COVID 19.

Sipas këtij plani, AKAFPK e fokusoi punën në këto prioritetet kryesore:

- Publikimi dhe këshillimi i Listës Kombëtare e Profesioneve (LKP);
- Zhvillimi i analizave të punës dhe hartimi i standardeve të profesioneve;
- Zbatimi dhe zhvillimi i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve në sektorin e AFP-së
- Hartimi i përshkrimeve të kualifikimeve për nivelet 2- 5 të KShK-së
- Hartimi i skeletkurikulave për kualifikimet profesionale të niveleve 2-5 të KShK-së;
- Hartimi i materialeve mësimore mbështetëse për mësues e nxënës të arsimit të mesëm profesional në zbatim të skeletkurikulave;
- Hartimi i programeve orientuese për provimet e niveleve të arsimit të mesëm profesional si dhe hartimi i programeve orientuese për maturën shtetërore profesionale;
- Hartimi i bankave të testeve si instrument mbështetës për mësimdhënësit në hartimin e provimeve të niveleve të arsimit të mesëm profesional;
- Mbështetja e shkollave profesionale për zhvillimin e mësimit dhe vlerësimit në kushtet e shtëpisë, për lëndët profesionale dhe modulet profesionale në arsimin profesional në kushtet e pandemisë.
- Sigurimi i cilësisë në AFP.

Gjatë këtij viti, AKAFPK ka koordinuar veprimtarinë me MFE-në dhe Agjencinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi për të lehtësuar përdorimin e Listës Kombëtare të Profesioneve të përditësuar, miratuar me VKM nr. 514, datë 20.09.2017. Gjithashtu, është ofruar këshillim dhe orientim për të interpretuar rubrika të LKP sipas kërkesës së përdoruesve të ndryshëm duke lehtësuar aksesin për të gjithë përdoruesit.

Në kuadrin koordinimit të punës për ngritjen e Komiteve sektoriale, me mbështetjen e RISI Albania, është zhvilluar një Udhërrëfyes për ngritjen e komitetit sektorial i cili merr në

konsideratë praktikat më të mira të operacionilizimit të nje mekanizmi të tille në vende të tjera si Portugalia, por duke e kotekstualizuar me ralitetin në vend në konsultë të ngushtë edhe me partnerët socialë. Gjithashtu, gjatë këtij viti është zhvilluar metodologjia për prioritizimin e sektorëve më qëllim përzgjedhjen e sektorit të parë për të cilin so të ngrihet komiteti sektorial.

Gjatë këtij viti, janë përshtatur 5 përshkrime profesionesh si bazë për hartimin e kurseve afatshkurta dhe janë finalizuar 19 standarde profesionesh, nga të cilat 4 janë standarde rajonale profesionesh për Ballkanin Perëndimor. Gjithashtu, 19 përshkrime të kualifikimeve profesionale të niveleve 2-5 të KShK-së janë zhvilluar, lista e detajuar e të cilave gjendet në anekset e këtij raporti.

Në kuadrin e përshtatjes së skeletkurrikulave të AP me kërkesat e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, Sektori i ka *rishikuar të gjitha skeletkurrikulat* (118 skeletkurrikula) e kualifikimeve profesionale të AP dhe i ka publikuar në një format të ri në faqen e internetit të AKAFPK.

Gjatë vitit 2020, janë hartuar, rishikuar dhe përmirësuar 23 skeletkurrikula për vitet shkollore 2020-21 dhe 2021-22. Me mbështetjen e Save the Children, është rishikuar programi dhe materiali mësimor mbështetës për lëndën “*Bazat e sipërmarrjes*”.

Gjithashtu janë hartuar 10 programeve për Kurset e unifikuara të Formimit profesional publik (Lista e detajuar gjendet në anekset e këtij raporti).

Për të mbështetur mësuesit e lëndëve profesionale dhe nxënësit në AP, duke konsideruar që në AP ka mungesa të theksuara të teksteve mësimore, si dhe në kushte e pandemisë ku mësimi online ka patur prioritet, është analizuar gjendja, dhe janë përcaktuar nevojat më emergjente. Bazuar në këto evidenca janë hartuar 25 materiale mësimore mbështetëse të lëndëve profesionale. Në bashkëpunim me OeAD janë hartuar edhe 35 materiale mësimore në mbështetje ta zbatimit të kurrikulës në drejtimin e Hoteleri turizmit.

Në zbatim të Urdhërit të përbashkët të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me Nr. 115, dt. 18.05.2020, “Për trajtimin e kërkesave të personave për pajisje me programet mësimore lëndore të zbatuara në institucionet arsimore të arsimit të mesëm të lartë në Republikën e Shqipërisë para vitit shkollor 2008-2009”, janë përgatitur 48 programe sintetike të zbatuara në shkollat profesionale para vitit 2008.

Gjatë vitit 2020, AKAFPK ka mbikëqyrur zbatimin e produkteve kurrikulare në SHP-të dhe DRFPP-të, si dhe ka udhëzuar e këshilluar drejtuesit dhe mësuesit/instruktorët në lidhje me to. Kjo mbështetje është kryer si nëpërmjet kontakteve dhe takimeve të drejtpërdrejta (gjatë takimeve në AKAFPK dhe vizitave në shkolla profesionale dhe DRFPP) ashtu edhe nëpërmjet komunikimeve në distancë dhe online (e-mail, biseda telefonike, ëëbinare). Informacione me

vlere janë marrë edhe gjatë trajnimeve didaktike dhe për aspekte të tjera, të dhjetra mësuesve dhe drejtuesve të shkollave profesionale dhe DRFPP-ve. Janë bërë propozime konkrete për ndryshimet e nevojshme në sistemin e zhvillimit të vazhduar profesional të mësimeve në AFP, duke qenë pjesë aktive e ndryshimeve ligjore për institucionalizimin dhe mbështetjen e “njësive të zhvillimit” në ofruesit e AFP.

Në kuadër të fillimit të vitit shkollor 2020-21, është përgatitur dhe publikuar “*Udhëzuesi për drejtuesit dhe mësuesit e shkollave profesionale*” me informacione mjaft të dobishme për aspektet kurrikulare, të mësimit, të vlerësimit të nxënësve, të organizimit orarit të shkollave, të orientimit të tyre nga kërkesat e tregut rajonal të punës etj.

Në kuadrin e përhapjes së pandemisë COVID 19 dhe të kalimit të mësimit pjesërisht dhe plotësisht online në periudha të caktuara të vitit 2020, është përgatitur një *Udhëzues për mësimin dhe vlerësimin në kushtet e shtëpisë* për shkollat profesionale dhe më pas, është realizuar një *analizë* e hollësishme nëpërmjet një pyetësoari (online), plotësuar nga 450 mësues, si dhe kontakteve me 21 shkolla profesionale. Raporti në lidhje me ecurinë dhe problematikat e zbatimit të mësimit në kushtet e shtëpisë është publikuar në faqen e internetit të AKAFPK-së.

Edhe gjatë vitit 2020, janë trajnuar 35 mësues dhe instruktorë në Programin e Trajnimit 24 ditor për “*Bazat e didaktikës në AFP*”, të mbështetur nga OeAD (Austri).

Është përgatitur programi i trajnimit është zhvilluar trajnimi 25 Koordinatorëve të Marrëdhënieve me Biznesin (KMB) të “njësive të zhvillimit”, në kuadrin e Programit rajonal “Shkolla takon Biznesin” (mbështetur nga OeAD). Gjithahshhtu, është hartuar Manuali për Garantimin e Cilësisë në marrëdhëniet shkollë – biznes dhe janë trajnuar (online) KMB-të dhe drejtues të shkollave në lidhje me zbatimin e këtij manuali (rreth 50 pjesëmarrës).

Gjithashtu, janë zhvilluar trajnimeve për dhjetëra mësues dhe instruktorë të shkollave profesionale në drejtimin “Hoteleri-turizëm”, si dhe instruktorëve (mentorëve) të biznesit, të mbështetura respektivisht nga programet A1 – Tour dhe S4J.

Në bashkëpunim me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Sektori ka mbështetur edhe hartimin e Programit Kombëtar të Kualifikimit, si dhe përgatitjen e testeve përkatëse për kualifikimin (atestimin) e mësuesve dhe instruktorëve të kulturës profesionale në AP, për vitin 2020.

Gjatë këtij viti, është koordinuar procesi i hartimit të 6 programeve të reja orientuese për provimet përfundimtare të niveleve, si dhe janë rishikuar 19 programeve ekzistuese orientuese. Gjithashtu, janë hartuar 5 programe orientuese për kurset e unifikuara të formimit profesional.

Gjatë këtij viti, është përmirësuar edhe regjistri për të gjithë ofruesit, me të dhëna si numri i nxënësve që ofrohen në drejtim/profimet përkatëse në të gjithë sistemin tonë të AP-së.

Gjatë këtij viti, u hartuar 2 programe orientuese të reja dhe u përditësuan 4 programe orientuese të Maturës Shtetërore Profesionale me referencat e bazës ligjore (Udhëzuesi i përbashkët MASR-MFE dhe Rregullorja e Maturës Shtetërore 2020).

U rishikuan 37 Programe orientuese të Maturës Shtetërore Profesionale të gjendur në situatën e jashtëzakonshme të pandemisë, COVID-19, për shkak të përjashtimit nga programet orientuese temat të cilat ishin realizuar në kushtet e shtëpisë. Procesi i rishikimit u bazua në analizën e thelluar të informacionit të detajuar të grumbulluar nga të gjitha shkollat e Arsimit Profesional, për të gjitha drejtim/profilet që kishin dalje në Maturën Shtetërore Profesionale.

Gjithashtu, janë hartuar 1400 njësi të testit në përputhje me planin vjetor për këtë qëllim, duke plotësuar nevojën për to në kualifikimet profesionale. Janë zhvilluar vizitat nëpër të gjithë ofruesit e AFP-së me qëllim mbështetjen në përdorimin e këtyre bankave në vlerësim e vazhduar dhe përfundimtar të nxënësve.

Gjithashtu, janë hartuar dhe rishikuar suplementet e certifikatave profesionale për 26 drejtimet/profilet në arsim profesional.

Në kuadrin e sigurimit të cilësisë, me mbështetjen e Programit “Zhvillimi i Aftësive për Punësim” të UNDP-së në bashkëpunim me MFE, janë zhvilluar 4 takime rajonale me drejtues dhe përfaqësues të ekipeve të vetëvlerësimit për të diskutuar për ecurinë e procesit të vetëvlerësimit, problemet e hasura dhe masat që duhen marrë është finalizuar paketa e Vetëvlerësimit të IoAFP-së. Procesi i konsultave u ndërpre gjatë periudhës prill-qershor për shkak të situatës së jashtëzakonshme të krijuar nga COVID 19 dhe prioritetit të zhvillimit të mësimin online, për të rifilluar në shtator dhe përmbyllur në shtator të 2020.

Me kërkesë të AKAFPK dhe me mbështetjen e Programit “Zhvillimi i Aftësive për Punësim” të UNDP-së, është konceptuar një platformë digjitale e cila do të shërbejë si instrument për të mbështetur edhe ofruesit e AFP-së në zbatimin e procesit të vetëvlerësimit.

Gjatë këtij, me mbështetjen e Programit “Zhvillimi i Aftësive për Punësim” të UNDP-së është konceptual modeli i akreditimit të ofruesve publik dhe jopublik të AFP-së. Procesi është drejtuar nga një ekspert ndërkombëtar, me shumë përvojë në këtë fushë dhe anëtar i ENQAVET. Ndërkohë, janë zhvilluar takime me përfaqësues të MFE dhe MASR dhe të institucioneve në varësi të tyre, me ofrues të AFP-së dhe partnerë socialë, për të grumbulluar informacion të nevojshëm mbi situatën aktuale që lidhen me procedurat e licencimit dhe/apo akreditimit apo të modeleve të ngjashme të akreditimit. Drafti paraprak i modelit të akreditimit u konsolidua përmes një procesi konsultimi në 2 ëorkshope virtuale, dhe përmban procedura të detajuara, standarde dhe kriteret për akreditimin e ofruesve të AFP-së në Shqipëri, si dhe një roadmap për zbatimin e këtij procesi në vend. Ky set dokumentash shërben si bazë për plotësimin e kuadrit nënligjor në këtë fushë.

Me mbështetjen e OEAD janë zhvilluar dy takime 2 ditore me drejtues dhe mësues të të gjitha shkollave për zhvillimin e kapaciteteve në përdorimin e rezultateve të vetëvlerësimit për përmirësimin dhe zhvillimin e cilësisë së shkollave.

AKAFPK, në përputhje me objektivat dhe misionin ligjor të saj, në zbatim të Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 21, datë 9.7.2015 “Për procedurat e transferimit të nxënësve nga një nivel/drejtimit i arsimit profesional në gjimnaz, në zbatim të “Rregullores së brendshme të AKAFPK-së për procedurat e transferimit të nxënësve shqiptarë ose të huaj, të cilët transferojnë studimet nga shkollat profesionale jashtë shtetit në shkollat profesionale në Shqipëri - procedura e njëvlershmërisë së studimeve të kryera” ka kryer njehsimin e programeve të ndjekura nga 3 nxënësit shqiptarë që kanë shprehur kërkesat për transferimin e studimeve të tyre nga shkollat profesionale jashtë shtetit në shkollat profesionale në Shqipëri.

Në profilin e një institucioni qendror përgjegjës për sigurimin e cilësisë në AFP, AKAFPK është angazhuar në Forumin për Sigurimin e Cilësisë në AFP të lançuar nga ETF në nëntor 2017. Gjithashtu, AKAFPK merr pjesë me një anëtar të nominuar nga qeveria shqiptare në Bordin Këshillimor të KEK.

Përpos veprimtarive të bazuara në funksionet thelbësore të saj, AKAFPK ka zbatuar disa projekte të financuara nga programi Erasmus+ i BE-së, si dhe veprimtari të tjera edhe sipas prioriteve në Strategjinë Kombëtare për Aftësi dhe Punësim 2019-2022.

Veprimtari në kuadrin e Task Forcës për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve

AKAFPK është angazhuar në Task Forcën e KShK-së për zhvillimin dhe zbatimin e mëtejshëm të KSHK-së, mandati i së cilës është rinovuar për 2 vite të tjera në janar 2020. Gjatë këtij viti, Task Force ka ri-aktivizuar grupe teknike përkatëse të ngritura me qëllim zbatimin e procesit të referencimit. Në këto grupe marrin pjesë përfaqësues/ekspertë të fushës së arsimit të lartë, arsimit para universitar të përgjithshëm dhe arsimit dhe formimit profesional, nga drejtoria e përgjithshme e politikave dhe programeve të zhvillimit në MASR, drejtoria e integritit, marrëveshjeve dhe asistencës në MASR, ASCAP, QSHA, ASCAL, AKAFPK, drejtoria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional në MFE dhe përfaqësues të institucioneve ofruese, shoqatave të biznesit, sindikatave, etj.

Zbatimi i projektit “EPALE National Support Services 2019-2020” /Erasmus+

Si qendër kombëtare mbështetëse e emëruar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, AKAFPK ka nënshkruar Marrëveshjen e Grantit për promovimin e Platformës Elektronike për të Nxënësit të Rriturve në Evropë (EPALE) në periudhën 2019-2020. Gjatë vitit 2020, bazuar në direktivat e EACEA është aplikuar për shtyrje të projektit deri në mars të viti 2022, e cila është miratuar tashmë.

Në zbatim të planit të punës së këtij projekti, janë organizuar takime me institucione ofruese, politikë bërës dhe organizata në fushën e të nxënit të të rriturve. Në vijim janë organizuar tre takime rajonale të zhvilluara në Kavajës, Lushnjës dhe Skrapar, ndërkohë që për shkak të situatës së krijuar nga COVID 19, takimet e planifikuara u shtynë për vitin 2021.

Takimet rajonale janë zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional, me përfaqësues të pushtetit lokal, bashki dhe prefektura, drejtori arsimore, universitete, si dhe aktorë të tjerë që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në kuadrin e arsimit të të rriturve.

Pjesëmarrësit ishin aktivë dhe të interesuar të njiheshin me Platformës EPALE si dhe prioritetet dhe zhvillimet në sektorin e të nxënit të të rriturve. Për promovimin e Platformës EPALE, takime informuese janë zhvilluar edhe në kuadrin e veprimtarive të organizuara nga partnerët të të tjerë, si p.sh në kuadrin e javës së aftësive të zhvilluar në Tiranë, etj.

Gjithashtu, në zbatim të këtij projekti janë publikuar në këtë platformë elektronike, si dhe në rrjetet sociale artikuj, lajme, studime mbi të nxënit e të rriturve, sipas indikatorëve të përcaktuar nga donatori.

Lidhur me menaxhimin teknik e financiar të këtij projekti, AKAFPK raporton periodikisht Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Gjithashtu, gjatë këtij viti AKAFPK përgatiti raportin e ndërmjetëm për projektin e zbatuar gjatë vitit 2019.

Marrëveshja e Grantit 614329-EPP-1-2019-1-AL-EPPKA3-AL-AGENDA “National Coordinators for the Implementation of the EU Adult Learning Agenda”, në programin Erasmus+

Gjatë këtij viti, ka vijuar zbatimi i projektit për mbështetjen e njësisive zhvillimore në Ofruesit e AFP-së për zhvillimin e rolit të orientimit për karriere. Është zhvilluar një studim për gjendjen e orientimit dhe zhvillimit për karrierë në vendin tonë, duke patur si qëllim analizën e situatës, problemet dhe sfidat në zhvillimin e nje qasje të orientimit në karrierë në AFP të harmonizuar me zhvillimet e tjera në vendin dhe në botë.

Zbatimi i projektit “FORWORK – Fostering Opportunities of Refugee Eorkers”, Marrëveshja e Grantit nr. VS/2017/0446, në kuadrin e programit të Bashkimit European për punësimin dhe inovacionin social (EASI)

Në kuadrin e zbatimit të projektit “FORËORK – Fostering Opportunities of Refugee Eorkers”, me Marrëveshjen e Grantit nr. VS/2017/0446, programi i Bashkimit European për punësimin

dhe inovacionin social (EASI), Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit për arritjen e qëllimit kryesor të projektit për të zhvilluar një plan individual të integritit për azilkërkuesit në vend, ka zhvilluar takime koordinuese në bashkëpunim me Adriapol, me Ministrinë e Punëve të Brendshme, dhe aktorë të tjerë të tillë si UNICEF, UNHCR IOM, etj. me qëllim grumbullimin e informacionit të nevojshëm për të identifikuar grupin e synuar, si dhe për të krijuar ura bashkëpunimi për të vepruar në përputhje me politikat dhe praktikën ekzistuese në Shqipëri. Për shkak të situatës së krijuar nga COVID, projekti kaloi në një proces amendimi. Në fund të viti bazuar edhe planin e projektit, nënkontraktoi një mësues të gjuhës shqipe për të zbatuar procesin mësimor të gjuhës shqipe nga 30 Azilkërkues. Zbatimi i procesit mësimor po koordinohet nga partneri tjetër lokal, ADRIAPOL.

Veprimtari për rregullimin e praktikave profesionale të nxënësve/kursantëve në biznes

Rregullorja për praktikën profesionale të nxënësve në biznes u miratua në shtator të këtij viti. Ndërkohë me mbështetjen e OEAD u organizuan 4 takime konsultative me bizneset partnere dhe mësues e drejtues në shkollat “Hoteleri-Turizëm” Tiranë, “Hysen Çela” Durrës, “Enver Qiraxhi” Pogradec, “Isuf Gjata” Korçë dhe “Antoni Athanas” Sarandë me qëllim për të prezantuar modalitetet e zbatimit të rregullores për praktikën profesionale në biznes dhe efektet e tyre në cilësinë e mësimdhënies dhe mbarëvajtjen e marëdhënies shkolle-biznes.

Problematikat

Baza ligjore ekzistuese në arsim dhe formim profesional përcakton domosdoshmërinë e rishikimit institucional dhe nevojën e zgjerimit të gamës së funksioneve në përgjigje të prioritetëve për zhvillimin e sistemit të kualifikimeve profesionale, veçanërisht të zhvillimit dhe zbatimit të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) dhe të rritjes së efektivitetit dhe efikasitetit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 426, datë 26.6.2019 “Për mënyrën e organizimit, të funksionimit, si dhe kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të komiteteve sektoriale dhe mënyrën e shpërblimit të tyre” nuk ka parashikuar shpërbimin e anëtarëve të Komitetit sektorial. Parashikimi i masës së shpërblimit është thelbësor për të institucionalizuar modalitetet e angazhimit dhe për pasojë për të rritur cilësinë e kontributit të palëve.

Miratimi i strukturës dhe organikës së propozuar nga AKAFPK do të mbështesë modernizimin e KSHK-së rritjen e zbatueshmërisë së saj në kuadrin e përafrimit të këtij kuadri ligjor me rekomandimet e Këshillit Evropian të 22 majit 2017 për “Kornizën Evropiane të Kualifikimeve për të nxënësit gjatë gjithë jetës” (2017 / C 189/03), si dhe zhvillimin cilësor të ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional me ngritjen e sistemit të kualifikimit të vazhduar të personelit mësimdhënës në AFP. Sfide mbetet plotësimi me prioritet i vendeve të lira në organikë.

Gjithashtu, Situata e krijura nga COVID 19 ka krijuar vështirësi në koordinimin e veprimtarive përkatëse dhe ka ridimensionuar veprimtaritë e institucionit duke i dhënë prioritet mbarëvajtjes së zhvillimit të procesit mësimor në kushtet e shtëpisë.

ANEKSE: VEPRIMTARITË E DETAJUARA SIPAS SEKTORËVE

ANEKS I VEPRIMTARIA E SEKTORIT TË PROFESIONEVE DHE KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE

Veprimtari lidhur me Profesionet

Gjatë këtij viti, fokusi i veprimtarisë së sektorit në kuadrin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP) ka qenë mbështetja e përdoruesve të saj. Sektori ka mbështetur dhe orientuar përdorues të ndryshëm përmes materialeve informuese të LKP në format tekst dhe në format elektronik. Janë zhvilluar takime orientuese me subjekte të interesuara për përdorimin dhe interpretimin e informacionit të LKP, të tilla si dhoma e zejeve, Shoqata Shqiptare e Turizmit, etj., por edhe takime informuese me partnerë ndërkombëtarë si ETF dhe GIZ. Gjithashtu, është koordinuar puna me Shërbimin Kombëtar të Punësimit për të përdorur informacione të LKP në sistemin e tyre të informacionit. Janë zhvilluar takime në rajone të ndryshme, kryesisht në institucionet ofruese të AFP-së për të promovuar LKP dhe lehtësuar përdorimin e saj me qëllim të orientimit më të mirë në tregun e punës.

Në mbështetje të procesit të zhvillimit të kurrikulës për kurse afatshkurtra të unifikuara është identifikuar nevoja për këto kurse në bashkëpunim me Shërbimin Kombëtar të Punësimit, si dhe është përshtatur informacioni i 7 përshkrimeve të profesioneve dhe është hartuar një standard profesioni me ekspertë të këtij profesioni nga bizneset. Këto të dhëna mbi profesionet kanë shërbyer si dokument bazë për hartimin e kurrikulave për kurset afatshkurtra të unifikuara.

Gjithashtu janë hartuar 10 standarde profesionale me përfaqësues të bizneseve. Në kuadrin e projektit Toëards regionally based occupational standards (TO REGOS) i zbatuar nga ERISEE, është punuar me 5 vendet e Ballkanit për zhvillimin e një metodologjie dhe formati të përbashkët të standardit të profesionit, që do të shërbejnë si bazë për hartimin e standardeve të krahasueshme të profesioneve ndërmjet vendeve duke synuar lehtësimin e lëvizjes së lirë të mbartësve të kualifikimeve që do të bazohen në këto standarde profesionale.

Veprimtari lidhur me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve

II.1. Draft lista kombëtare e kualifikimeve profesionale

Janë zhvilluar vizita në 34 shkolla profesionale në Tiranë, Kamëz, Durrës, Golem, Kavajë, Lezhë, Shkodër, Rubik, Kukës, Peshkopi, Bulqizë, Elbasan, Cërrik, Korçë, Lushnje, Berat, Fier,

Vlorë, Sarandë dhe Gjirokastër, me qëllim të përditësimit të listës së kualifikimeve profesionale sipas nevojave të tregut por edhe të ndërgjegjësimit të ofruesve lidhur me llojshmërinë e kualifikimeve pjesë e listës kombëtare, për të diversifikuar portofolin e kualifikimeve sipas nevojave të rajonit.

Më qëllim zhvillimin e mekanizmave të feedback-ut të institucioneve ofruese të AFP-së lidhur me relevancën e kualifikimeve në rajonet e tyre, Sektori ka marrë pjesë në ëorkshopet e organizuara nga projekti “Skills For Jobs” në rajone të ndryshme të vendit.

Me mbështetjen e GIZ, është hartuar studimi mbi profesionet dhe aftësitë e reja profesionale në sektorin e Mekatronikës në Shqipëri, gjetjet e të cilit u prezantuan në muajin maj në një ëorkshop validues, në të cilin morën pjesë një spektër i gjerë aktorësh, me përfaqësues të kompanive në sektor, përfaqësues të politikë bërësve, ofruesve të AFP-së, etj. Në këtë takim të gjithë pjesëmarrësit u angazhuan në mënyrë aktive në diskutime, duke sjellë përvojën dhe vizionin e tyre në lidhje me kualifikimet e nevojshme aktualisht në Shqipëri, duke sjellë një vlerë të shtuar në studim për të orientuar vendimmarrjen për hapat e mëtejshëm në zhvillimin e ofertës së kualifikimeve për sektorin e mekatronikës.

II.2. Përshkrimet të kualifikimeve profesionale

Gjatë këtij viti, janë hartuar 23 përshkrime të kualifikimeve profesionale të niveleve 2, 3 dhe 4 të KShK-së janë zhvilluar, në terma të rezultateve të nxënimit për njohuritë, shprehjet profesionale dhe kompetencat më të përgjithshme në përputhje me përshkruesit e niveleve të KSHK-së. Në këtë proces janë angazhuar mbi 100 bashkëpunëtorë duke përfshirë përfaqësues të bizneseve të ndryshme, por edhe mësues të shkollave profesionale. Lista e detajuar e përshkrimeve të kualifikimeve profesionale është në aneksin I.

II/3. Veprimtari në kuadrin e Task Forcës për KSHK dhe anëtarësimin në Grupin Këshillimor të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (KEK)

AKAFPK është angazhuar në Task Forcën e KShK-së për modernizimin e kuadrit ligjor për KSHK-në dhe në vijim të punës për plotësimin e kuadrit ligjor në mbështetje të ligjit Nr. 23/2018 “Për disa Ndryshime dhe Shtesa në Ligjin Nr. 10 247, Datë 4.3.2010, “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve. Në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë është punuar për propozim për ndryshim të aktin nënligjor për shpërblimit e anëtarëve të komitetit sektorial, si dhe përgatitjen e Urdhrit të Përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për ngritjen e komitetit të parë sektorial..

Në kuadrin e veprimtarisë së Task Forcës për KSHK, është kontribuar në të gjitha takimet e zhvilluara gjatë këtij viti, me prezantime, informacione, komente dhe sugjerime për çështje të ndryshme që lidhen me KSHK.

Me mbështetjen e RISI Albania, në kuadrin e pilotimit të komitetit sektorial në sektorin e mikpritjes dhe turizmit, është zhvilluar një vizitë studimore në Portugali, për të transferuar përvojën e tyre në ngritjen dhe funksionimin e 16 komiteteve sektoriale në vend. Gjithashtu, me mbështetjen e S4E janë zhvilluar takime bashkëpunimi me aktorë të rëndësishëm në zhvillimin e dhe zbatimin e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve në Dublin për të shkëmbyer përvoja, praktika dhe mësim të nxjerra lidhur me aspekte të zhvillimit dhe zbatimit të kornizave të kualifikimeve.

Në kuadrin e procesit të referencimit të KSHK me KEK, me mbështetjen e UNDP po punohet me ekspertë lokalë dhe ndërkombëtare për hartimin e raportit dhe janë aktivizuar grupet teknike për të përgatitur dhe/apo ofruar informacione për materiale të ndryshme studimore sipas kërkesës.

IV. Veprimtari në kuadër të zbatimit të projekteve për “Platformën elektronike të të nxëniet të të rriturve” (EPALE), AL-AGENDA

Në kuadrin e projektit EPALE dhe AL-AGENDA është kontribuar në takimet e organizuara në kuadrin e Projektit EPALE, si dhe në vlerësimin e kandidatëve për ekspertë në kuadrin e projektit. Gjithashtu, është kontribuar me informacione përmbajtjesore (Blog) në platformë për evente të ndryshme në AFP.

V. Bashkëpunim me MFE dhe institucione të tjera

Në kuadrin e hartimit të akteve nënligjore në mbështetje të ligjit nr. 15/2017 datë 16.2.2017 për AFP-në, është kontribuar me komente, sugjerime për draft-aktet nënligjore përkatëse, si dhe në hartimin e draft udhëzimit për miratimin e Katalogut Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale . Është asistuar në panairin dhe olimpiadën e aftësive të organizuar për promovimin e AFP-së. Gjithashtu, është dhënë kontribut për plotësimin e fishave për raport progresin SKAP 2014-2020. AKAFPK është kontribuese e rëndësishme në Kapitullin 26, por edhe në kapitujt 2, 3 për përafrimin e legjisllacionit me *Acquis e BE*.

Gjithashtu, Sektori ka bashkëpunuar me MFE dhe MASR për rishikimin e udhëzimit për Maturën Shtetërore Profesionale 2019.

Përfaqësues të sektorit kanë marrë pjesë në takime të ndryshme të organizuara nga institucione të ndryshme, të tilla si:

- Kontribut në grupin e punës për hartimin e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 15/2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit për KSHK.

- Pjesëmarrje në takimet shpjeguese për Kapitujt 2 dhe 26 në Bruksel
- Pjesëmarrje në takime parapërgatitore në MEPJ, MFE dhe MASR me qëllim koordinimin e takimit shpjegues për Kapitujt 2 dhe 26.
- Pjesëmarrje në platformën e diskutimit për të nxënit në vendin e punës organizuar nga Kulturë Kontakt.
- Pjesëmarrje dhe moderim i Ëorkshopit për Kuadrin rregullator të të nxënit me bazë punën, organizuar nga KulturKontakt, në Tiranë.
- Pjesëmarrje në seminarin për rishikimin e planit të veprimit të strategjisë Kombëtare për punësim dhe aftësim organizuar në Rogner nga ETF dhe MFE më 27 Mars 2019.
- Pjesëmarrje dhe kontribut me prezantim në shkollën verore të organizuar nga S4J.
- Monitorim i vlerësimit të mësuesve dhe instruktorëve të Arsimit dhe Formimit Profesional në Shqipëri në kuadër të zbatimit të Programit të 24 ditor “Bazat e Didaktikës”.
- Kontribut për konsolidimin e informacionit për Profilin e koordinatorit për marrëdhënie me biznesin, organizuar nga KulturKontakt, në Tiranë
- Kontribute me komente dhe sugjerime për studime që lidhen me AFP, të zhvilluar nga të tretë.
- Zhvillimi i takimeve konsultative me përfaqësues të tregut të punës lidhur me nevojat e tyre për kualifikime profesionale në fushën e hoteleri turizmit në kuadër të hartimit të standardit kombëtar dhe rajonal të profesionit ‘Teknik/Menaxher i mesëm në hotele dhe restorante’.
- Pjesëmarrje dhe kontribut në takimin e organizuar në Shkodër me temë “Adresimi i nevojave të tregut të punës në sektorin e tekstit nëpërmjet ofertave të reja në arsimin profesional” organizuar nga projekti Sëisscontact “Skills For Jobs”.
- Pjesëmarrje në Ëorkshop – tryeza vendore e dialogut për zhvillimin e aftësive “Industria tekstile dhe galanteria” organizuar nga Aftësitë për Punë, “Skills For Jobs” në Berat dhe lidhur me Industrinë e Hotelierisë në Vlorë.
- Pjesëmarrje në Ëorkshop të organizuar me mbështetjen e “Kultur Kontakt Austria” dhe projektit “Partnerë për fëmijë” lidhur me pasqyrimin e barazisë gjinore në dokumentet e kualifikimit dhe ato kurrikulare të arsimit dhe formimit profesional.

VI. Kontribute në kuadrin e zhvillimit të bashkëpunimit me agjenci homologe dhe me projekte të tjera

Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale ka kontribuar me prezantime në takimin e organizuar në Vjenë, si dhe në takimin e Rrjetit të Agjencive të AFP në vendet e Evropës Jug-Lindore duke pasur si qëllim nxitjen e bashkëpunimit në kushtet e impaktit të dixhitalizimit.

Gjithashtu, në kuadrin e bashkëpunimit me donatorët në fushë, sektori është organizuar në këto veprimtari:

- Pjesëmarrje në tri takime koordinuese të rrjetit të Agjencive, SEEVET, i organizuar nga Sekretariati i ERI SEE.
- Pjesëmarrje në takim, në Beograd, në kuadër të ERISSEE lidhur me përcaktimin e metodologjisë dhe procedurave për hartimin e standardeve rajonale të profesioneve.

- Pjesëmarrje në takimet e Aleancës për Ballkanin Perëndimor mbi Eëork-based Learning (EëBA for WBL) në Beograd dhe Shkup lidhur me hartimin e standardit rajonal të profesionit “Teknik/Menaxher i mesëm në hotel dhe restorant”.
- Pjesëmarrje në Konferencën “Skills and qualifications”, organizuar nga ETF, Torino, Itali.

SPKP – Lista e Produkteve 2019

Produkte që lidhen me profesionet

I. Analizat e profesionit të përshtatura nga LKP për zhvillimin e kurseve afatshkurtra

1. “Punëtor i paneleve diellore”.
2. “Punëtor në pemtari”.
3. “Udhërrëfyes turistik”.
4. “Mekanik i makinave industriale”.
5. “Instalues dhe mirëmbajtës i sistemeve ngrohëse-ftohëse”
6. “Mekanik xhenerik në automjetet e lehta”.
7. “Shitës”.

II. Standarde profesioni të finalizuara

1. Ndihmës në TIK
2. Instruktor i gjuhës së shenjave shqipe
3. Punëtor për mbledhje, kultivim dhe përpunim të bimëve mjekësore – aromatike
4. Punëtor për mbledhje, kultivim dhe përpunim të frutave të malit
5. Teknik në hotel dhe restorant
6. Agromekanizator
7. Gurgdhendës
8. Suvatues për punime tradicionale në ndërtesa
9. Punëtor i kualifikuar për punime druri tradicionale
10. Ndihmës në autoservis

Produkte që lidhen me fushën e kualifikimeve profesionale

I. Studim mbi profesionet dhe aftësitë e reja profesionale në sektorin e Mekatronikës në Shqipëri (me mbështetjen e GIZ)

II. Lista e përshkrimeve të kualifikimeve

1. “Rrobaqepësi”, niveli III në KSHK (rishikim)
2. “Modelim”, niveli III në KSHK (rishikim)
3. “Teknologjia e përpunimit të naftës”, niveli III në KSHK (rishikim)
4. “Sigurime”, niveli IV në KSHK (rishikim)
5. “Sipërmarrje e Agjencisë Turistike”, niveli IV në KSHK (rishikim)
6. “Makinat metalpunuese”, niveli III në KSHK (rishikim)
7. “TIK”, niveli II në KSHK, (rishikim)
8. “Llogari”, niveli IV në KSHK (rishikim)
9. “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli III në KSHK (rishikim)
10. “Frutikulturë”, niveli III në KSHK (rishikim)
11. “Kopshtari”, niveli III në KSHK (rishikim)
12. “Instalime dhe mirëmbajtje të linjave të TU dhe TL”, niveli III në KSHK (rishikim)
13. “Riparime të pajisjeve elektro-shtëpiake”, niveli III në KSHK (rishikim)
14. “Ndërtim”, niveli IV në KSHK (rishikim)
15. “Përpunim druri”, niveli IV në KSHK (rishikim)
16. “Mbarështim të kafshëve dhe shpendëve”, niveli III në KSHK (rishikim)
17. “Elektromekanikë”, niveli III në KSHK (rishikim)
18. “Mekanikë”, niveli IV në KSHK (rishikim)
19. “Tekstil”, niveli III në KSHK (rishikim)
20. “Tekstil-konfeksion”, niveli IV në KSHK (rishikim)
21. “Prodhim bimor”, niveli III në KSHK
22. “Shërbime bankare”, niveli IV në KSHK (rishikim)
23. “Shërbime mjetesh transporti”, Niveli II në KSHK (rishikim)

ANEKS II VEPRIMTARIA E SEKTORIT TË SKELETKURRIKULAVE DHE STANDARDEVE TË TRAJNIMIT TË MËSUESVE NË AFP (SSTM)

Rezultatet e veprimtarisë së Sektorit të Skeletkurrikulave dhe Standardeve të Trajnimit të Mësuesve të AFP-së (Viti 2020)

Gjatë vitit 2020, veprimtaria e Sektorit të Skeletkurrikulave dhe Standardeve të Trajnimit të Mësuesve të AFP (SSTM) është mbështetur në Planin e punës së AKAFPK, në Planin e punës dhe objektivat e Sektorit, si dhe në objektivat specifike për çdo punonjës të tij. Fokusi i Sektorit ka qënë jo vetëm përmbushja e objektivave për aspektet sasiore të produkteve të planifikuara, por edhe garantimi i cilësisë së proceseve dhe produkteve përkatëse.

Veprimtaria e Sektorit gjatë vitit 2020 është kushtëzuar edhe nga vështirësitë dhe kufizimet e krijuara për shkak të përhapjes së pandemisë COVID 19, duke sjellë edhe ndryshimin dhe zgjerimin e objektivave të planifikuara. Fuqizimi i komunikimit dhe i mbështetjes së shkollave profesionale për mësimin online, puna me grupet e bashkpunëtorëve në kushtet e distancimit social, komunikimet dhe takimet online, oraret e reduktuara të punës së përbashkët, këto janë disa tipare të veprimtarisë së Sektorit të SSTM gjatë muajve të pandemisë.

Përgjithësisht, Sektori i SSTM i ka përmbushur me sukses objektivat e planifikuara ose të rishikuara sipas situatave dhe mundësive konkrete. Përmbushja e objektivave erdhi edhe si rezultat i të qenit aktiv nga secili antar i sektorit, i punës në grup, i bashkëpunimit me sektorët e tjerë të Agjencisë, me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Me Agjencinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, me institucione të tjera, me Shkollat Profesionale dhe Drejtoritë Rajonale të FP Publik (DRFPP), me partnerët socialë, me donatorët etj. Shkëmbimi i përvojave dhe vullneti për të ngritur në mënyrë të vazhdueshme nivelin profesional të anëtarëve të Sektorit ka ndikuar gjithashtu pozitivisht në përmbushjen e detyrave.

Kontributet e Sektorit të SSTM

Në zbatim të funksioneve të tij, Sektori i SSTM, gjatë vitit 2020, ka kontribuar nëpërmjet kryerjes së një tërësie procesesh dhe realizimit të disa produkteve kryesore që kanë mbështetur zhvillimin e AFP si në nivel qendror, ashtu edhe në nivelin e ofruesve (shkollave profesionale dhe qendrave të formimit profesional).

Më poshtë renditen kontributet kryesore të sektorit, të ndara sipas fushave të veprimtarisë.

I. Hartimi dhe rishikimi i dokumentacionit kurrikular për AFP dhe mbështetja e zbatimit të tij.

Përgatitja e dokumentacionit kurrikular (skeletkurrikula, programe kursesh të unifikuara, materiale mësimore mbështetëse, programe lëndore dhe module profesionale) përbën vëllimin

më të madh të punës së sektorit të SSTM edhe gjatë vitit 2020. Moderimi i hartimit të dokumentacionit të ri kurrikular është bërë në përputhje me metodologjinë dhe formatet e miratuara dhe në zbatim të Udhëzimit të MFE, Nr. 27, dt. 30.07.2018, "Për formatet dhe procedurat kurrikulare të AFP". Hartimi i dokumentacionit kurrikular është mbështetur edhe në dokumentet përkatëse të përgatitura nga Sektori i SPKP (përshkrime të profesioneve, standarde të profesioneve dhe përshkrime të kualifikimeve). Garanci për cilësinë e tyre ka qenë edhe përvoja e dhjetëra individëve dhe grupeve të punës me specialistë të arsimit dhe formimit profesional, si dhe të biznesit, të përzgjedhur me kujdes nëpërmjet procedurave zyrtare të AKAFPK.

Në kuadrin e përshtatjes së skeletkurrikulave të AP me kërkesat e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, Sektori i ka rishikuar të gjitha skeletkurrikulat (118 skeletkurrikula) e kualifikimeve profesionale të AP dhe i ka publikuar në një format të ri në faqen e internetit të AKAFPK.

Sektori i SSTM ka mbikëqyrur dhe ka marrë informacione për ecurinë e zbatimit të skeletkurrikulave dhe programeve të kurseve të unifikuara nëpërmjet vizitave, takimeve të drejtpërdrejta dhe takimeve online me drejtues, mësues dhe instruktorë për shumicën e shkollave profesionale dhe DRFPP-ve. Veçanërisht për drejtimin e Hoteleri turizmit, janë organizuar takime të drejtpërdrejta dhe online për mbledhje informacioni. Bazuar në të dhënat e mbledhura, si dhe në ndryshimet në përshkruesit e kualifikimeve përkatëse, Sektori ka moderuar procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të 23 skeletkurrikulave për vitet shkollore 2020-21 dhe 2021-22. Me mbështetjen e Save the Children, është rishikuar programi dhe materiali mësimor mbështetës për lëndën "Bazat e sipërmarrjes".

Përsa i përket programeve të kurseve të unifikuara të formimit profesional, Sektori moderoi hartimin e 10 programeve për Kurset e Unifikuara të FP, bazuar edhe në përshkrimet e profesioneve përkatëse.

Për të mbështetur mësuesit e lëndëve profesionale dhe nxënësit në AP, duke konsideruar që në AP ka mungesa të theksuara të teksteve mësimore, si dhe në kushte e pandemisë ku mësimi online ka patur prioritet, Sektori ka analizuar gjendjen, ka përcaktuar nevojat më emergjente dhe ka moderuar procesin e hartimit të 25 materialeve mësimore mbështetëse të lëndëve profesionale.

Në zbatim të Urdhërit të përbashkët të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me Nr. 115, dt. 18.05.2020, "Për trajtimin e kërkesave të personave për pajisje me programet mësimore lëndore të zbatuara në institucionet arsimore të arsimit të mesëm të lartë në Republikën e Shqipërisë para vitit shkollor 2008-2009", Sektori i SSTM ka përgatitur 22 programe sintetike të zbatuara në shkollat profesionale para vitit 2008 dhe ka plotësuar kërkesat për 48 aplikues, për të tilla programe.

Gjatë vitit 2020, Sektori i SSTM ka kryer produrat e duhura dhe ka mundësuar transferimin e 3 nxënësve, nga shkollat profesionale jashtë vendit, në shkollat profesionale të vendit tonë.

II. Trajnimi dhe udhëzimi i mësuesve dhe drejtuesve në AFP.

Gjatë vitit 2020, Sektori i SSTM ka mbikëqyrur zbatimin e produkteve kurrikulare në SHP-të dhe DRFPP-të, si dhe ka udhëzuar e këshilluar drejtuesit dhe mësuesit/instruktorët në lidhje

me to. Kjo mbështetje është kryer si nëpërmjet kontakteve dhe takimeve të drejtpërdrejta (gjatë takimeve në AKAFPK dhe vizitave në shkolla profesionale dhe DRFPP) ashtu edhe nëpërmjet komunikimeve në distancë dhe online (e-mail, biseda telefonike, ëëbinare). Informacione me vlerë janë marrë edhe gjatë trajnimeve didaktike dhe për aspekte të tjera, të dhjetra mësuesve dhe drejtuesve të shkollave profesionale dhe DRFPP-ve, në të cilat tre antarë të Sektorit kanë qenë edhe trajnerë.

Në kuadër të fillimit të vitit shkollor 2020-21, Sektori kontribuoi në përgatitjen dhe publikimin e një *“Udhëzuesi për drejtuesit dhe mësuesit e shkollave profesionale”* me informacione mjaft të dobishme për aspektet kurrikulare, të mësimdhënies, të vlerësimit të nxënësve, të organizimit orarit të shkollave, të orientimit të tyre nga kërkesat e tregut rajonal të punës etj. Përsa i përket mbështetjes së mësimdhënësve të AFP për aspektet didaktike, specialistët e Sektorit, në takimet, bashkëbisedimet dhe vëzhgimet e kryera në shkollat profesionale dhe DRFPP-të, kanë marrë të dhëna për gjendjen e mësimdhënësve dhe kanë ofruar mbështetjen e tyre për aspekte të ndryshme didaktike. Sektori ka bërë propozime konkrete për ndryshimet e nevojshme në sistemin e zhvillimit të vazhduar profesional të mësimdhënësve në AFP, duke qenë pjesë aktive e ndryshimeve ligjore për institucionalizimin dhe mbështetjen e “njësive të zhvillimit” në ofruesit e AFP.

Në kuadrin e përhapjes së pandemisë COVID 19 dhe të kalimit të mësimin pjesërisht dhe plotësisht online në periudha të caktuara të vitit 2020, Sektori i SSTM, në bashkëpunim me sektorët e tjerë të Agjencisë, përgatiti një *Udhëzues për mësimin në kushtet e shtëpisë* për shkollat profesionale dhe më pas, kreu një *analizë* të hollësishme nëpërmjet një pyetëso (online), plotësuar nga 450 mësues, si dhe kontakteve me 21 shkolla profesionale. Sektori, në bashkëpunim me sektorët e tjerë, përgatiti një Raport në lidhje me ecurinë dhe problematikat e zbatimit të mësimin në kushtet e shtëpisë.

Edhe gjatë vitit 2020, Sektori është angazhuar në zbatimin e Programit të Trajnimit 24 ditor për *“Bazat e didaktikës në AFP”*, të mbështetur nga OeAD (Austri). Tre pjestarë të Sektorit kanë kontribuar drejtpërdrejt jo vetëm në koordinimin dhe harmonizimin e zbatimit të këtij programi, por edhe në trajnimin e drejtpërdrejtë të grupit të mësuesve të shkollave dhe DRFPP-ve të rajonit Verilindor (rreth 35 pjesmarrës).

Anëtarët e Sektorit të SSTM janë angazhuar edhe si trajnerë në moderimin e seancave të trajnimeve (online) për dhjetra mësues dhe instruktorë të shkollave profesionale në drejtimin *“Hoteleri-turizëm”*.

Antarë të Sektorit kanë kontribuar në përgatitjen e programit të trajnimit dhe në zbatimin e trajnimit të 25 Koordinatorëve të Marrëdhënieve me Biznesin (KMB) të “njësive të zhvillimit”, në kuadrin e Programit rajonal *“Shkolla takon Biznesin”* (mbështetur nga OeAD). Në këtë kontekst, sektori ka kontribuar edhe në hartimin e një Manuali për Garantimin e Cilësisë në marrëdhëniet shkollë – biznes dhe në trajnimin (online) të KMB-ve dhe drejtuesve të shkollave në lidhje me zbatimin e këtij manuali (rreth 50 pjesmarrës).

Antarë të Sektorit kanë kontribuar në përgatitjen e një dokumenti konceptual për Zhvillimin e Vazhduar Profesional të mësimdhënësve të AFP në Shqipëri, si bazë për ndryshime të mundëshme institucionale dhe ligjore në këtë komponent të reformës së AFP si dhe për të orientuar mbështetjen teknike të këtij procesi.

III. Veprimtari në kuadrin e bashkëpunimeve.

Një pjesë e ndjeshme e kohës së punës së Sektorit të SSTM i është kushtuar veprimtarive të ndryshme në kuadrin e porosive të Ministrisë përgjegjëse për AFP (MFE) dhe të bashkëpunimeve të kryera me institucione kombëtare dhe aktorë të tjerë, me me projektet e donatorëve dhe institucionet e ndryshme ndërkombëtare që janë partnerë të rëndësishëm në zhvillimin e AFP në Shqipëri. Të tilla veprimtari janë:

- Pjesmarrje në procesin e rishikimit të kuadrit ligjor të AFP, hartimit të drafteve të akteve nënligjore të AFP (kryesisht për aspektet e ristrukturimit të funksioneve të AKAFPK, të ndërtimit dhe funksionimit të ofruesve të AFP, të sistemit të kualifikimit të mësimdhënësve, të akreditimit të ofruesve, të gjenerimit të programeve mësimore para vitit 2008 etj.). Këto kontribute janë dhënë nëpërmjet pjesëmarrjes në grupet e punës përkatëse, në përgatitjen e drafteve të para ose në formën e komenteve me shkrim për draftet e paraqitura.
- Pjesmarrje në Komitetin e Maturës Shtetërore.
- Pjesmarrje në takime për diskutimin, si dhe komentimi i dokumenteve të ndryshme të Drejtorisë apo të sektorëve të tjerë të AKAFPK, në kuadrin e bashkëpunimit të brendshëm të AKAFPK
- Pjesëmarrje në Komisionin e përzgjedhjes së anëtarëve të grupeve të punës për produktet e AKAFPK
- Pjesëmarrje në Komisionin e transferimit të nxënësve në AP.
- Pjesmarrje në komisionin e inventarizimit në AKAFPK.
- Pjesmarrje në komisionin për prokurimet publike të AKAFPK
- Përgatitja e planit të buxhetit të Sektorit SSTM si dhe ndryshimet eventuale gjatë vitit.
- Komente dhe plotësime në Rregulloren dhe Udhëzimin për Maturën Shtetërore Profesionale, 2020-21.
- Komente për Urdhërin për fillimin e vitit shkollor 2020-21 (kërkesë nga MASR)
- Takime në MFE për aspekte të ndryshme të AFP.
- Takime, diskutime konsultime të vazhdueshme dhe pjesmarrje aktive në veprimtaritë e EPALE
- Pjesmarrje aktive në Ëëbinar-et e EPALE
- Moderimi i tre takimeve (të drejtpërdrejta dhe online) në Korçë, Sarandë dhe Tiranë me mësues e drejtues të shkollave për marrje informacioni dhe dhënie udhëzimesh për zbatimin e skeletkurrikulave të drejtimit "Hoteleri turizëm" dhe të profileve përkatëse (bashkëpunim me AI-Tour).
- Moderimi i trajnimeve për mësuesit e lëndëve/moduleve profesionale të drejtimit "Hoteleri turizëm" në lidhje me planifikimin e mësimdhënies dhe vlerësimit (bashkëpunim me AI-Tour).
- Pjesmarrje në Programin rajonal (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut) "Shkolla takon Biznesin", mbështetur nga OeAD.
- Pjesmarrje në takimet për planifikimin e veprimtarive të Projektit AI-Tour (OeAD)
- Pjesmarrje dhe kontribute në takimet online dhe veprimtaritë e organizuara nga ETF për programin e trajnimit të Koordinatorëve të ZHVP dhe aspekte të tjera të AFP.
- Takime dhe kontribute në kuadrin e veprimtarive online të projektit S4J.

- Takime dhe shkëmbime informacioni me konsulentët e Programit për hartimin e skeletkurrikulit “Shërbime mekatronike në automjete” (GIZ)
- Pjesmarrje dhe prezantime në Takimet dhe Trajnimet për “Shkolla takon Biznesin”, organizuar në Tiranë ose online (OeAD).
- Pjesmarrje në takimet dhe ëbinaret online për aspekte të ndryshme të AFP, organizuar nga S4J, GIZ, PEMA, EPALE, ERI SEE, ETF, UNDP, ITC.

IV. Veprimtari të tjera.

Sektori i SSTM gjatë vitit 2020 ka kryer edhe veprimtari të tjera që lidhen me:

- Përgatitjen e dokumentacionit zyrtar që ka të bëjë me veprimtarinë dhe produktet e Sektorit (raporte mujore dhe vjetore, plane mujore dhe vjetore, listë-prezenca të stafit, shkresa të ndryshme, njoftime për bashkëpunëtorët, përzgjedhja e bashkëpunëtorëve, kontratat për bashkëpunëtorët, dokumentacioni për pagesat e bashkëpunëtorëve, planifikimi i buxhetit të sektorit, dokumentacioni financiar, vlerësimi i stafit, materialet për publikime në faqe interneti etj.).
- Kontribute në rifreskimin me informacione të faqes së internetit të AKAFPK.
- Trajnimin e vazhdueshëm të stafit të Sektorit të SSTM. Kjo është kryer nëpërmjet studimit individual, shkëmbimit të përvojës, pjesëmarrjes në veprimtari trajnimi të drejtpërdrejt ose online, kryesisht të ofruara nga ASPA dhe donatorët, ndjekjes së kualifikimeve formale etj.

Një përmbledhje e produkteve kryesore të Sektorit të SSTM, të realizuara gjatë vitit 2020, tregohet në Aneksin 1 (shih më poshtë).

Sektori i SSTM – Lista e produkteve për vitin 2020

I. Skeletkurrikula të reja:

1. “Teknikë peshkimi”, Niv III i KSHK.
2. “Shërbime mekatronike në automjete”, Niv. IV i KSHK.
3. “Teknologji bujqësore”, Niv IV i KSHK.

II. Skeletkurrikula të rishikuara:

1. “Instalime elektrike civile dhe industriale”, Niv. III i KSHK
2. “Instalime dhe mirëmbajtje të linjave TU dhe TL”, Niv. III i KSHK.
3. “Modelim”, Niv. III i KSHK.
4. “Kopshtari”, Niv. III i KSHK.
5. “Mbarështrim i kafshëve dhe shpendëve”, Niv. III i KSHK.
6. “Hoteleri turizëm”, Niv. IV i KSHK.
7. “Riparim i pajisjeve elektroshtëpiake”, Niv. III i KSHK.
8. “Elektromekanikë”, Niv. III i KSHK.
9. “Tekstil”, Niv. III i KSHK.
10. “Tekstil konfeksion”, Niv. IV i KSHK.
11. “Prodhim bimor”, Niv. III i KSHK.
12. “Shërbime kujdesi për fëmijë”, Niv. III i KSHK.

13. "Tregti", Niv. IV i KSHK.
14. "Mekanikë", Niv. IV i KSHK.
15. "Termohidraulikë", Niv. II i KSHK.
16. "Shërbime mjetesht transporti", Niv. II i KSHK
17. "Bujqësi" Niveli IV i KSHK.
18. "Gjeologji-miniera", Niv. II i KSHK.
19. "Telekomunikacion", Niv. IV i KSHK.
20. "Riparime elektronike", Niv. IV i KSHK.

III. Programe lëndore

1. Rishikimi i programit sintetik dhe analitik për lëndën "Bazat e sipërmarrjes", kl.12
2. Rishikimi i programit sintetik dhe analitik për lëndën "Bazat e sipërmarrjes", kl.13

IV. Programe të Kurseve të Unifikuara të formimit profesional publik:

1. "Instruktor i gjuhës së shenjave shqipe".
2. "Manikyr dhe pedikyr".
3. "Punime karrocierie në automjete".
4. "Punime në makinat metalprerëse".
5. "Punime duralumini".
6. "Bojatisje".
7. "Sekretari".
8. "Kopshtari".
9. "Punime mekanike".
10. "Sisteme të thata në ndërtesa".

V. Programe sintetike të gjeneruara për periudhën para vitit 2008

1. Administrim dhe mirëmbajtje rjetesh kompjuterike-5 vjeçar (2007)
2. Elektrik-3 vjeçar (2000)
3. Elektrik i përgjithshëm-5 vjeçar (2000)
4. Elektronik-5 vjeçar (2001)
5. Elektroteknik-5 vjeçar (1999)
6. Hidraulik-3 vjeçar (1999)
7. Hoteleri-3 vjeçar (1999)
8. Hoteleri turizem-5 vjeçar (2001)
9. Hoteleri turizem-5 vjeçar (2006)
10. Mekanik-4 vjeçar (1986)
11. Mekanik automobilash-3 vjeçar (1996)
12. Mekanik automobilash-3 vjeçar (2008)
13. Mekanik i përgjithshëm-3 vjeçar (2000)
14. Mobileri-3 vjeçar (2007)
15. Teknik ndërtimi-5 vjeçar (2000)
16. Teknologji ushqimore-5 vjeçar (2003)
17. Teknologji ushqimore-4 vjeçar (1986)

18. Zooteknik-4 vjeçar (1987)
19. Telekomunikacion-5 vjeçar (2003)
20. Hidraulik-3 vjeçar (2005)
21. Termohidraulik-3 vjeçar (2001)
22. Instalim hidraulik dhe ventilim-5 vjeçar (2007)

VI. Materiale mësimore mbështetëse për lëndët profesionale:

1. "Drejtimi, ligjshmëria dhe ekonomia në bujqësi", kl 13", (96 orë), të drejtimit mësimor "Bujqësi", Niveli IV i KSHK.
2. "Bazat e bujqësisë", kl.10, (108 orë), të drejtimit mësimor "Bujqësi", Niveli II i KSHK.
3. "Njohuri mbi ndërtesat", kl.10, (72 orë), të drejtimit mësimor "Termohidraulikë", Niveli II i KSHK
4. "Dendrometri", kl. 11 (68 orë), të drejtimit mësimor "Pyje", niveli II i KSHK
5. "Psikopedagogjia", kl.10 (72 orë), të drejtimit mësimor "Shërbime sociale dhe shëndetësore", Niveli II i KSHK
6. "Rrjetet e komunikimit", kl.12 (72 orë), të profilit mësimor "Riparime të pajisjeve elektronike", Niveli IV i KSHK.
7. "Hyrje në programim", kl.12 (36 orë) të profilit mësimor "Zhvillim ëeb-site", Niveli IV i KSHK
8. "Elektroteknika dhe mekatronika në mjetet e transportit", kl.11 (68 orë), të drejtimit mësimor "Shërbime mjeteve transporti", Niveli II i KSHK
9. "Bazat e programimit në ëeb", kl. 11 (68 orë) të drejtimit mësimor "Teknologji informacioni dhe komunikimi", Niveli II i KSHK
10. "Teknologji konstruksionesh prej beton të armuar", kl.12, (68 orë), të profilit mësimor "Karpentieri, hekurkthim dhe betonim", Niv. III i KSHK.
11. "Barnat mjekësore dhe alternative", kl.11, (68 orë), të drejtimit "Shërbime sociale dhe shëndetësore", Niv. II i KSHK.
12. "Kontabiliteti i sigurimeve", kl.12, (108 orë), të profilit mësimor "Sigurime", Niv. III i AP (Niv. IV i KSHK).
13. "Matje elektrike", kl.11, (68 orë), të drejtimit mësimor "Elektroteknikë", Niv. II i KSHK.
14. "Agroteknologji e kulturave të arave", kl.12 (102 orë), të profilit mësimor "Prodhim bimor", Niv. III i KSHK.
15. "Sjellje sipërmarrëse", kl.13, (64 orë), të profileve mësimore të drejtimit "Ekonomi biznes", Niv. IV i KSHK.
16. "Gjeografi e turizmit", kl.12, (108 orë), të profilit mësimor "Shërbime të udhëtimit dhe turizmit", Niv. IV i KSHK.
17. "Teknologji mekanike", kl.11, (102 orë), të drejtimit mësimor "Mekanikë", Niv. II i KSHK.
18. "Elektronikë", kl.11, (136 orë), të drejtimit mësimor "Elektroteknikë", Niv. II i KSHK.
19. "Bazat e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit", kl.10, (72 orë) dhe kl.11 (34 orë), të drejtimit mësimor "Teknologji informacioni dhe komunikimi", Niv. II i KSHK.
20. "Agroturizëm", kl.12, (102 orë), të profilit mësimor "Agroturizëm", Niveli III i KSHK.
21. "Edukim shëndetësor dhe higjienë", kl.10, (72 orë), të drejtimit mësimor "Shërbime social shëndetësore", Niveli II i KSHK.

22. "Mekanikë ndërtimi", kl.10, (72 orë), të drejtimit mësimor "Ndërtim", Niveli II i KSHK.
23. "Rrjete kompjuterike", kl.12, (108 orë), të profilit mësimor "Rrjete të dhënash", Niveli IV i KSHK.
24. "Telekomunikacion", kl.12, (108 orë), të profilit mësimor "Telekomunikacion", Niveli IV i KSHK.
25. "Bazat e sipërmarrjes", kl.12 (68 orë), për të gjitha drejtimet/profilet mësimore.

VII. Udhëzuesat:

1. Udhëzues për drejtuesit dhe mësuesit e shkollave profesionale, në kuadrin e fillimit të vitit shkollor 2020-2021 (në bashkëpunim)
2. Udhëzues për mësimin në kushtet e shtëpisë në Arsimin Profesional (në bashkëpunim)
3. Manual për Garantimin e cilësisë në bashkëpunimin shkollë – biznes (bashkëpunim - mbështetur nga OeAD).

ANEKS III SEKTORI I VLERËSIM-CERTIFIKIMIT TË NXËNËSVE & AKREDITIMIT TË OFRUESVE TË AFP-SË

REZULTATET E VEPRIMTARISË SË SEKTORIT TË VLERËSIM-CERTIFIKIMIT TË NXËNËSVE DHE AKREDITIMIT TË OFRUESVE TË AFP-SË

Përgjatë vitit 2020, Sektori i Vlerësim-certifikimit të nxënësve dhe Akreditimit të ofruesve të AFP-së (SVCA), për realizimin e veprimtarive të planifikuara, është mbështetur në objektivat vjetore të kësaj njësie organizative, si dhe në objektivat specifike për çdo punonjës të tij. Sektori është fokusuar në dy drejtime kryesore:

Zhvillimi i kriterëve dhe standardeve të vlerësimit të nxënësve/kursantëve

Sigurimi i Cilësisë

Realizimi i të gjitha objektivave të Sektorit në kohë dhe me cilësi, ka ardhur si rezultat edhe i rritjes së shkallës së dedikimit, angazhimit dhe punës në ekip të stafit, bashkëpunimit me sektorët e tjerë të Agjencisë, bashkëpunimit ndërinstitucional dhe me shkollat e qendrat e formimit profesional, si dhe me projektet e ndryshme. Si çdo vit, gjatë punës së tij, sektori konsultohet në vijimësi me dokumente të fushës së AFP-së si manuale, udhëzuesat dhe dokumente strategjike të ndryshëm.

Veprimtari për zhvillimin e kriterëve dhe standardeve të vlerësimit dhe certifikimit të nxënësve/kursantëve

Mbështetje në situatën e jashtëzakonshme COVID-19

Të ndodhur në situatën e gjendjes së jashtëzakonshme, në kuadër të pandemisë COVID-19, për t'u ardhur në ndihmë drejtuesve të shkollave profesionale, mësuesve të lëndëve teorike profesionale dhe instruktorëve të moduleve praktike profesionale për mënyrën se si të organizonin trajtimin on-line të procesit mësimor dhe si të mundësonin vlerësimin e nxënësve, në kushtet e shtëpisë, u përgatit udhëzuesi i mëposhtëm:

Kontribut në hartimin e Udhëzuesit për mësimin dhe vlerësimin në kushtet e shtëpisë, për lëndët profesionale dhe modulet profesionale në arsimin profesional.

Kontribut në analizën e përgjigjeve të pyetësorit on-line mbi ecurinë e zbatimit të mësimin në kushtet e shtëpisë.

Kontribut në hartimin e udhëzimit nr. 18, datë 8.05.2020 “Për organizimin e mësimit, vlerësimin e nxënësve, provimet përfundimtare dhe mbylljen e vitit shkollor 2019-2020, në shkollat profesionale publike dhe jopublike, në kushtet e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, të shkaktuar nga pandemia e COVID-19.

Hartimi dhe rishikimi i programeve orientuese të niveleve

Në kuadër të planit vjetor të punës, gjatë vitit 2020, Sektori ndërmori dhe monitoroi procesin e hartimit të 6 programeve orientuese për provimet përfundimtare të niveleve.

Për hartimin e programeve të reja sektori mblodhi informacion nga shkollat profesionale, për drejtimet/profilet e reja që ofrohen nga ato, për identifikimin e nevojave përkatëse. Informacion i mbledhur gjatë periudhës Tetor-Nëntor 2019. Po ky informacion është grumbulluar edhe në periudhën Tetor-Nëntor 2020, i cili do të nevojitet për planifikimin e planit 2021. Kështu, nga verifikimi i ofertës për vitin shkollor 2019-2020 rezultoi nevoja e hartimit të 6 programeve orientuese për provimet përfundimtare të niveleve.

Për rishikimin e programeve orientuese sektori mori informacionin e nevojshëm nga ndryshimet e bëra në skeletkurrikulat përkatëse. Nga verifikimi rezultoi nevoja e rishikimit të 20 programeve orientuese. (U rishikuan 19 prej tyre, pasi profili mësimor Rrobaqepësi niveli II, nuk u realizua për mosparaqitje të bashkëpunëtorëve).

Gjithashtu, është pasuar dhe regjistri për të gjithë ofruesit, me të dhëna si numri i nxënësve që ofrohen në drejtim/profilet përkatëse në të gjithë sistemin tonë të AP-së.

Hartimi i Programeve të reja orientuese të Kurseve të Unifikuara Kombëtare

Në këtë kuadër pas hartimit dhe miratimit të Programeve të Kurseve të Unifikuara, dhe sipas modelit të miratuar, u hartuan 5 Programe Orientuese të Kurseve të Unifikuara Kombëtare.

Hartimi dhe rishikimi i programeve orientuese të Maturës Shtetërore Profesionale

Për hartimin dhe rishikimin e programeve të reja orientuese të Maturës Shtetërore Profesionale, sektori mblodhi informacion nga shkollat profesionale, për drejtimet/profilet e reja që ofrohen.

Në këtë kuadër, u hartuan 2 programe të reja orientuese të Maturës Shtetërore Profesionale dhe u rishikuan 4 programe orientuese të Maturës Shtetërore Profesionale.

U rishikuan 37 Programe orientuese të Maturës Shtetërore Profesionale të gjendur në situatën e jashtëzakonshme të pandemisë, COVID-19. (u përjashtuan nga programet orientuese temat të cilat ishin realizuar në kushtet e shtëpisë). Ky informacion i detajuar u grumbullua nga të gjitha

shkollat e Arsimit Profesional, për të gjitha drejtim/profilet që kishin dalje në Maturën Shtetërore Profesionale.

U plotësuan 37 programe orientuese të Maturës Shtetërore Profesionale me referencat e bazës ligjore (Udhëzuesi i përbashkët MAS-MFE dhe Rregullorja e Maturës Shtetërore 2020).

Banka testesh

Një nga veprimtaritë e sektorit, në mbështetje të shkollave profesionale për ofrimin e kualifikimeve profesionale cilësore, është përgatitja e bankave me njësi testi (instrumente vlerësimi) për provimet përfundimtare, por edhe për vlerësimin e vazhduar të nxënësve. Për vitin 2020 ishte planifikuar hartimi i 1400 njësive të testit (për 7 drejtime mësimore). Sipas këtij planifikimi të gjitha njësitë janë realizuar. Mbas hartimit të tyre është duke u plotësuar kështu edhe niveli i III i kualifikimit. Shkollat janë orientuar t'i përdorin këto instrumente si gjatë vitit shkollor, ashtu edhe për hartimin e testeve të provimeve përfundimtare. Nga vizitat e kryera nëpër të gjithë ofruesit e AP-së për monitorimin e përdorimit të këtyre bankave rezultoi, se të gjitha shkollat i gjejnë një ndihmesë mjaft të vlefshme dhe i përdorin ato në vazhdimësi. Madje kanë kërkuar plotësimin edhe të drejtimeve të mbetura me njësi testi.

Certifikimi

Hartimi dhe rishikimi i suplementeve të certifikatave profesionale (që pasqyrohen në certifikatat e niveleve), për 26 drejtimet/profilet e të tri strukturave të ofruara, në nivelet përkatëse të tyre.

Sigurimi i Cilësisë

Në kuadër të Programit “Zhvillimi i Aftësive për Punësim” të UNDP-së dhe me mbështetjen e MFE dhe AKAFPK janë realizuar këto veprimtari:

Vetëvlerësimi

Në situatën e krijuar nga pandemia COVID-19, procesi i vetëvlerësimit në Institucionet Ofruese të Arsimit dhe Formimit Profesional u ndërpre deri në rikthimin në normalitet të gjendjes. Duke parë përmirësimin e situatës, u rishikua Plani i monitorimit të procesit të Vetëvlerësimit. Ky plan konsistoi në:

- ✓ Konsultimet me personat përgjegjës në ofruesit e AFP-së, për procesin e vetëvlerësimit.
- ✓ Mbështetjen dhe monitorimin e ofruesve të AFP-së për realizimin e procesit të vetëvlerësimit.
- ✓ Dorëzimi i raporteve përfundimtare nga ofruesit e AFP-së, brenda afateve të parashikuara sipas planit të rishikuar.
- ✓ Pjesëmarrje dhe kontribut për platformën elektronike të Vetëvlerësimit.

Akreditimi

- Takime me ofrues të AFP-së dhe institucione eprore, për të grumbulluar informacion të nevojshëm mbi situatën aktuale që lidhen me procedurat e licencimit apo modeleve të ngjashme të akreditimit.
- Hartimi i draftit paraprak të procedurave të detajuara, standardeve dhe kriterëve për akreditimin e AFP-së në Shqipëri.
- Finalizimi i modelit të akreditimit, procedurat dhe standardet.

Veprimtari në kuadër të bashkëpunimeve

Në kuadër të bashkëpunimit me MFE, janë kryer këto veprimtari:

- Në bashkëpunim me Drejtorinë e AFP-së, pranë Ministrisë së Financave Ekonomisë u përgatit drafti i Udhëzimit për “Organizimin dhe zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale 2020 dhe për Rregulloren e Maturës Shtetërore 2021.
- Ngritja e grupit të punës dhe përmirësimi i gjithë elementëve përmbajtësorë të dokumentacionit shkollor (amza, indeksi i amzës, regjistri i klasës, regjistri i veçantë i nxënësve në arsimin profesional).
- Pjesëmarrje në grupin e inspektimit për licencimin e ofruesve privat të AFP-së.

Në kuadër të bashkëpunimit me MAS, janë kryer këto veprimtari:

- Dhënia e kontributeve për hartimin e draftit të Rregullores së Maturës Shtetërore 2020-2021.
- Përgatitja e informacionit të kërkuar nga QSHA për të gjitha planet mësimore të drejttimeve/profileve të Arsimit Profesional, për Maturën Shtetërore Profesionale 2020, të ofruara nga shkollat profesionale publike dhe jopublike, informacion ky që shërben për platformën “Maturanti.”
- Mbështetja e QSHA-së në koordinimin e grupeve të punës për hartimin e testeve të teorisë profesionale të Maturës Shtetërore Profesionale 2020, për drejtimet/profilet e reja.
- Në bashkëpunim me QSHA-në, ndjekja e problematikës me nxënësit maturantë të shkollave profesionale, plotësimin e rubrikave të Certifikatës së Maturës Shtetërore Profesionale tek platforma “Maturanti.”
- Mbështetja dhe konsultimi i vazhdueshëm për problematikën e provimeve të Maturës Shtetërore 2020 dhe të dhënave të portalit “Maturanti”.
- Komente dhe sugjerime mbi draftin e strukturës të vitit të ri shkollor 2020-2021.
- Pjesëmarrje në takim në kuadër të implementimit të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP).

Në kuadër të projektit EPAL, janë kryer këto veprimtari:

- Pjesëmarrje në mbështetje të aktiviteteve për të Nxënit e të Rriturve.

Në kuadër të projektit Risi-Albania:

- Pjesëmarrje gjatë dy ditëve në ëorkshopin mbi Komitetet Sektoriale të Aftësive, nga ekspertet portugeze.

Veprimtari në kuadër të projektit të Kultur-Kontakt:

- Pjesëmarrje dhe moderim në takime me fokus “GENDER IN SELF-EVALUATION”.
- Kontribut në Manualin për integrimin dhe zbatimin e aspekteve gjinore në udhëzuesin për vetëvlerësimin e ofruesve të AFP-së në Shqipëri

Përgatitja e termave të referencës për bashkëpunëtorët e jashtëm

Pjesë e punës së sektorit është edhe përgatitja e termave të referencës për bashkëpunëtorët e jashtëm:

- Ndjekja e procedurave për njoftimet për bashkëpunëtorë, për hartimin apo rishikimin e programeve orientuese, si dhe hartimin e bankave të testeve për provimet përfundimtare.
- Përgatitja e kontratave të shërbimit, për bashkëpunëtorët e SVCA-së që shpallen fitues.
- Ndjekja e procedurave për pagesën e bashkëpunëtorëve.

Të tjera

Sektori është angazhuar edhe në disa veprimtari të tjera që lidhen ose jo drejtpërdrejt me përshkrimin e punës së tij:

- Përcaktimi i objektivave të vitit.
- Hartimi i planeve mujore të detajuara dhe raportimi i tyre.
- Hartimi i planit vjetor dhe raportimi i tij.
- Mirëmbajta e rubrikës së Vlerësim Certifikimit në faqen e AKAFP-së.

SVCA – Lista e produkteve 2020

Programe orientuese të reja:

- 1) Elektroteknikë Niveli I
- 2) Animim social Niveli II
- 3) Agroturizëm Niveli II
- 4) Kujdesi për të moshuar (Pilot GIZ) Niveli III
- 5) Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji Niveli III
- 6) Shërbime në hotel dhe restorant Niveli II

Programe orientuese të rishikuara:

- 1) Mekanikë Niveli I
- 2) Shërbime sociale dhe shëndetësore Niveli I
- 3) Ekonomi biznes Niveli I

- 4) Reception Niveli II
- 5) Bar-restorant Niveli II
- 6) Kuzhinë-pastiçeri Niveli II
- 7) Guida turistike Niveli II
- 8) Shërbime motorike Niveli II
- 9) Shërbime xhenerike Niveli II
- 10) Konstruksione metalike Niveli II
- 11) Mirëmbajtje dhe riparime mekanike Niveli II
- 12) Mobileri dhe tapiceri Niveli II
- 13) Karpenteri, hekurkthim dhe betonim Niveli II
- 14) Punime dhe riparim rrugësh Niveli II
- 15) Rrobaqepësi Niveli II (është shtyrë për mosparaqitje të bashkëpunëtorëve)
- 16) Teknologji e përpunimit të mishit dhe peshkut Niveli II
- 17) Veterinari Niveli III
- 18) Përpunim druri Niveli III
- 19) Ndërtim Niveli III
- 20) Teknologji ushqimore Niveli III

Programe orientuese të Kurseve të unifikuara:

- 1) Bojatisje
- 2) Sekretari
- 3) Kopshtari
- 4) Punime mekanike
- 5) Sisteme të thata në ndërtesa

Programe orientuese të reja të Maturës Shtetërore Profesionale

- 1) Kujdesi për të moshuar (Pilot GIZ)
- 2) Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji

Programe orientuese të rishikuara të Maturës Shtetërore Profesionale

- 1) Veterinari
- 2) Përpunim druri
- 3) Ndërtim
- 4) Teknologji ushqimore

Programe orientuese të Maturës Shtetërore Profesionale

- 1) Hoteleri-turizëm
- 2) Shërbime mjetesh transporti

- 3) Mekanikë
- 4) Elektroteknikë
- 5) Elektronikë
- 6) Përpunim druri
- 7) Ndërtim
- 8) Tekstil-konfeksione
- 9) Tekstil-konfeksione (NABER ADA)
- 10) Teknologji ushqimore
- 11) Bujqësi
- 12) Shërbime sociale dhe shëndetësore
- 13) Instalues i sistemeve termohidraulike
- 14) Teknologji kimike
- 15) Peshkim
- 16) Detari
- 17) Gjeologji-miniera
- 18) Llogari
- 19) Shërbime bankare
- 20) Sipërmarrje e agjencisë turistike
- 21) Sigurime
- 22) Tregti
- 23) Administrim biznesi
- 24) Rrjete të dhënash
- 25) Mbështetje e përdoruesve të TIK
- 26) Zhvillim Eëbsite
- 27) Rrjete të dhënash (pilot-giz)
- 28) Inxhinieri informatike softëaresh (Hermann Gmeiner)
- 29) Silvikulturë
- 30) Agrobiznes
- 31) Veterinari
- 32) Gjeodezi
- 33) Biznes (Harry Fultz)
- 34) Elektronikë (Harry Fultz)
- 35) Automekanik (Harry Fultz)
- 36) Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji
- 37) Shërbime kujdesi për të moshuar (pilot GIZ)

Banka testesh (1400 njësi):

- 1) Tekstil-konfeksione Niveli III

- 2) Teknologji ushqimore Nivelii III
- 3) Bujqësi Nivelii III
- 4) Teknologji Kimike Nivelii III
- 5) Shërbime sociale dhe shëndetësore Nivelii III
- 6) Gjeologji miniera Nivelii III
- 7) Detari Nivelii III

Suplementi i certifikatave profesionale për 26 drejtime/profile sipas (ANEKSI 1)

ANEKS IV SEKTORI I ADMINISTRATËS, FINANCËS DHE TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Viti 2020 ka qenë një vit i vështirë për të gjithë, duke u përballuar me pasojat e pandemisë globale të COVID-19.

Për respektimin e kushteve të reja, për ruajtjen e shëndetit dhe mbajtjes së distancës sociale në periudhën e pandemisë, punonjësit e AKAFPK-së kanë kombinuar punën në ambientet e institucionit dhe atë në distancë nga banesat e tyre.

Gjatë vitit 2020, veprimtaria e Sektorit të Administratës, Financës dhe Teknologjisë së Informacionit (SAFTI) është mbështetur në planin e punës së AKAFPK-së dhe planin e punës dhe objektivat e sektorit. Ky sektor në bashkëpunim me sektorët e tjerë ka realizuar objektivat dhe detyrat e mëposhtme:

1. Në situatën e vështirë të pandemisë, në muajin maj, DAP miratoi rregulloren tip e cila përcaktoi qartë mënyrën e organizimit të punës në distancë dhe nga zyra për punonjësit e administratës shtetërore. Më pas, rregullorja e përcjellë nga MFE u përshtat dhe u unifikua në përputhje me specifikat e AKAFPK-së. Bashkëlidhur kësaj rregulloreje u vendos grafiku i punonjësve që do të punonin online nga banesat e tyre apo nga zyrat, duke respektuar oraret zyrtare dhe mënyrën e ushtrimit të detyrës gjatë gjendjes së pandemisë. Kjo rregullore u afishua në faqen elektronike zyrtare të AKAFPK-së dhe u vu në dispozicion të çdo punonjësi nëpërmjet email-it zyrtar. Krahas rregullores është raportuar çdo ditë pranë MFE mbi planifikimin dhe realizimin e detyrave të çdo punonjësi të sektorit.
2. Zbatimi i të ligjit nr. 152/2013, të ndryshuar për shërbimin civil ka vazhduar të jetë në qendër të vëmendjes së qeverisë shqiptare si pjesë e përpjekjeve të Shqipërisë për reformimin e shtetit edhe gjatë vitit 2020. Departamenti i Administratës Publike (DAP), si institucioni publik, qendror, përgjegjës për menaxhimin, mbikëqyrjen e shërbimit civil në të gjitha institucionet e administratës qendrore ka dhënë udhëzime dhe trajnime në ndihmë të konsolidimit dhe mirëfunksionimit të regjistrit elektronik HRMIS (Human Resources Management Information System), sistemin e menaxhimit të regjistrit të punonjësve të Administratës Publike.
Në përputhje me udhëzimet periodike të DAP-it, nëpunësi i AKAFPK-së, që merret me burimet njerëzore ka vazhduar punën me plotësimin e regjistrit HRMIS me të dhënat kryesorë të punonjësve të AKAFPK-së. Gjenerimi i pagave në Sistemit Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SMIBNJ/HRMIS) është realizuar çdo muaj të vitit 2020 nga nëpunësi zbatues i AKAFPK-së.
3. AKAFPK përfaqësohet nga faqja elektronike zyrtare me adresë: ëëë.akafp.gov.al. Kjo faqe është aktive dhe përditësohet me veprimtari e njoftime të ndryshimit për t'i ardhur në ndihmë bashkëpunëtorëve shqiptarë apo të huaj, të interesuar në realizimin e produkteve në fushën e AFP-së. Në rritje të transparencës, është publikuar, gjithashtu, mënyra e funksionimit të institucionit, mënyra e financimit të tij, e organizimit, struktura, adresa e institucionit, numrat e kontaktit si dhe adresa elektronike. Gjithashtu, në këtë faqe elektronike pasqyrohen veprimtaritë e projekteve të AKAFPK-së në kuadër të Programit “ERASMUS + dhe EASI. Sektori i AF&TI, veç rolit kryesor në përditësimin e ëeb-it të AKAFPK-së, ka administruar dhe mirëmbajtur rrjetin kompjuterik të institucionit.

4. Në kuadër të përmirësimit të komunikimit të brendshëm në platformën elektronike “Ehatsapp”, rekomanduar nga MFE, për të lehtësuar shpërndarjen e informacionit në kohë reale për të gjithë punonjësit e MFE dhe të institucioneve të saj të varësisë, AKAFPK nëpërmjet grupit të punonjësve të saj, ka shkëmbyer informacione në shërbim të objektivave institucionale.
5. Në bazë të ligjit nr. Nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, Rregullores mbi “Normat tekniko–profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” duke qenë se në organikën e AKAFPK-së nuk ka punonjës me detyrën e arkivit dhe protokollit, 2 nga punonjësit e sektorit të AF&TI krahas detyrave funksionale të tyre kryejnë protokollimin dhe arshivimin e dokumentacionit zyrtar. Lidhur me sa më sipër janë protokolluar dokumentet e vitit 2020 si edhe janë realizuar regjistrimet elektronike të tyre në funksion të mirë menaxhimit të dokumentit zyrtar të AKAFPK-së.
6. Krahas punës periodike në administrimin e dokumentacionit zyrtar elektronik e fizik të AKAFPK-së, në përputhje me procedurat administrative të Institucionit si edhe legjislacionit aktual, sektori ka kontribuar në hartimin e programit të transparencës së AKAFPK-së si edhe rifreskimin e vazhdueshëm të tij. Programi i transparencës përcakton kornizën e veprimtarisë së Agjencisë në kuadër të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe është i pasqyruara në faqen zyrtare elektronike të AKAFPK-së, në adresën: <http://ëëë.akafp.gov.al/rreth-nesh/programi>.
7. AKAFPK, në përputhje me objektivat dhe misionin ligjor të saj, në zbatim të Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Ministrisë të Arsimit dhe Sportit nr. 21, datë 9.7.2015 “Për procedurat e transferimit të nxënësve nga një nivel/drejtim i arsimit profesional në gjimnaz, në zbatim të “Rregullores së brendshme të AKAFPK-së për procedurat e transferimit të nxënësve shqiptarë ose të huaj, të cilët transferojnë studimet nga shkollat profesionale jashtë shtetit në shkollat profesionale në Shqipëri - procedura e njëvlershmërisë së studimeve të kryera” ka ndihmuar në procesin në çështje administrative. Në bashkëpunim me komisionin përkatës, sektori ka kontribuar në shqyrtimin e rasteve të paraqitura pranë AKAFPK-së në përputhje me legjislacionin në fuqi.
8. AKAFPK në bashkëpunim me MFE dhe SHKP ka inspektuar objektet shkollore mbi përmbushjen ose jo të standardeve normative nga ana e objektet shkollore, që aplikojnë për licencim pranë QKB-së. Lidhur me sa më lart, 1 përfaqësues i sektorit si pjesë e Grupit të inspektimit ka kontribuar në inspektimin e 1 objekti shkollor në muajin shtator 2020 me inspektimin pranë Qendrës së Arsimit dhe Formimit Profesional Flabina dhe mbajtjes së akt-inspektimit në këtë subjekt.
9. AKAFPK-ja është njësi koordinuese dhe përgjegjëse për zbatimin e Platformës Evropiane për Arsimin e të Rriturve (EPALE). Në kuadër të kësaj platforme AKAFPK ka zbatuar projektin EPALE NSS 2019-2020. Në këtë projekt, sektori i AF&TI ka dhënë kontributin e anëtarëve të tij në zbatim të objektivave të projektit dhe në përputhje me marrëveshjen e tij. Projekti do të shtrihet edhe për periudhën 2021. Veç kësaj, sektori ka kontribuar në hartimin e disa dokumenteve të nevojshme për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë(MFE).
10. Në kuadër të dy projekteve të tjera të AKAFPK-së si:1-“FORËORK-Fostering Opportunities of Refugee Eorkers” si edhe 2- “National Coordinators for the Implementation of the European Agenda”, sektori ka kontribuar në korrespondencat zyrtare midis Institucionit dhe MFE si edhe aktivitete implementuese të këtyre projekteve.
11. Sektori ka dhënë kontribut në projektin SELFIE (Self-reflection on Effective Learning by Fostering the use of Innovative Educational Technologies), i cili është një aplikacion i

- dizenjuar nga BE për të ndihmuar shkollat në përfshirjen e teknologjive numerike në mësimdhënie, të mësuarit dhe vlerësimin e nxënësve. Aplikacioni është aktualisht i vlefshëm në 24 gjuhët zyrtare evropiane duke përfshirë edhe gjuhën shqipe. SELFIE u pilotua 6 shkolla të mesme profesionale në Shqipëri nën mbështetjen e MFE dhe AKAFPK.
12. AKAFPK ne bashkëpunim me projektin “Zhvillimi i Aftësive për Punësim” (Skills Development for Employment- SD4E) i zbatuar nga UNDP, zhvilloi një platforme elektronike për procesin e vet-vlerësimit të shkollave të AFP-së duke përfshirë të gjithë elementet e cilësisë dhe fushat e nen-fushat e tij. Në këtë proces sektori dha ndihmese në takimet online e në zyrë lidhur me funksionalitetin e platformës.
13. Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 155, datë 24.11.2020 “Për Miratimin e Strukturës së Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve”, është punuar ngushtë me drejtorin e AKAFPK-së lidhur me përshkrimet e punës për pozicionet e punës që do të krijohen nga riorganizimi i këtij institucioni. Gjithashtu, në mbështetje të këtij riorganizimi është dhënë ndihmesë në përgatitjen e draft-rregullores së re të brendshme për organizimin dhe funksionimin e AKAFPK-së.
14. Për vitin buxhetor 2020, AKAFPK filloi aktivitetet e saj në janar 2020 me një buxhet të përgjithshëm prej 57,828,000 lekë, të miratuar nga MFE për artikullin 600, 601 dhe 602. Nga këto zëra, në këto artikuj, janë pakësuar fonde nga MFE në shumën 7,294,500 lekë. Pra, AKAFPK për vitin 2019 ka pasur në dispozicion një fond prej 50,533,500 lekë (artikulli 600, 601 dhe 602), prej të cilit ka realizuar aktivitetet e planifikuara sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela përmbledhëse e shpenzimeve të buxhetit të miratuar nga MFE dhe realizuar nga AKAFPK sipas planit për vitin 2020

KODI I PROJEKTIT	Artikulli	Plani I celur	Plani I ndryshuar	Fakti
91011AD	600	11,045,000	10,245,000	7,228,909
91011AE	600	1,200,000	7,300,000	4,802,354
91011AF	600	5,800,000	3,500,000	1,024,609
91011AG	600	2,800,000	1,300,000	
	SHUMA	20,845,000	22,345,000	13,055,872
91011AD	601	1,803,000	1,508,500	1,095,398
91011AE	601	1,200,000	1,200,000	1,077,368
91011AF	601	950,000	450,000	
91011AG	601	480,000	480,000	
	SHUMA	4,433,000	3,638,500	2,172,766
91011AD	602	12,000,000	10,000,000	7,211,064
91011AE	602	11,200,000	9,850,000	1,521,631
91011AF	602	6,400,000	2,000,000	930,721
91011AG	602	2,950,000	2,700,000	551,565
	SHUMA	32,550,000	24,550,000	10,214,981

Grafiku i shpenzimeve të buxhetit të miratuar nga MFE dhe realizuar nga AKAFPK sipas planit për vitin 2020




Tabela përmbledhëse e shpenzimeve të buxhetit të projektit “EPALE National Support Services (NSS) for Albania 2019-2020” në llogaritë Lek dhe Euro.

Llogaritë e Projektit	Buxheti i çelur në janar 2019	Buxheti i çelur gjatë vitit 2020	Buxheti gjithsej	Buxheti i realizuar	Buxheti i mbetur
Llogaria në Lek	43063	2558010	2601073	789511	1811562
Llogaria në Euro	0.7	7000	7000.7	0	7000.7

Tabela përmbledhëse e shpenzimeve të buxhetit të projektit “FORËORK” në llogaritë Lek dhe Euro për vitin 2019-2020

Llogaritë e Projektit	Buxheti i çelur në janar 2019	Buxheti i çelur gjatë vitit 2020	Buxheti gjithsej	Buxheti i realizuar	Buxheti i mbetur
Llogaria në Lek	1135269	0	1135269	0	1135269
Llogaria në Euro	10000	0	10000	0	10000

Euro					
------	--	--	--	--	--

Tabela përmbledhëse e shpenzimeve të buxhetit të projektit “AGENDA” në llogaritë Lek dhe Euro për vitin 2020

Llogaritë e Projektit	Buxheti i çelur në janar 2019	Buxheti i çelur gjatë vitit 2020	Buxheti gjithsej	Buxheti i realizuar	Buxheti i mbetur
Llogaria në Lek	442284	868070	1310354	247611	1062743
Llogaria në Euro	3520.7	0	3520.7	0	3520.7

Tabela përmbledhëse e buxhetit të mbetur nga projektit “Skemat e praktikës për punësimin e të rinjve në Shqipëri” në llogaritë Lek dhe Euro për vitin 2020, i cili është mbyllur.

Llogaritë e Projektit	Buxheti i çelur në janar 2019	Celur gjatë vitit 2020	Buxheti gjithsej	Buxheti i realizuar	Buxheti i mbetur
Llogaria në Lek	26161.92	0	26161.92	0	26161.92
Llogaria në Euro	25.94	0	25.94	0	25.94

15. Sektori ka bashkëpunuar me sektorët e AKAFPK-së dhe MFE për hartimin e Projekteve të Buxheteve Afatmesme dhe Afatgjata (PBA) të institucionit.
16. Në mbështetje të Ligjit nr. 9936 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave “Për përgatitjen e Programit Buxhetor 2020 – 2022 sektorët e AKAFPK kanë bashkëpunuar në përgatitjen e tij.
17. Në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar si edhe në zbatim të udhëzimit Nr.1, pika 7, datë 27.06.2014 “Për krijimin, funksionimin dhe përgjegjësitë e strukturave të autoriteteve përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave, në institucionet publike”, Autoriteti Përgjegjës Teknik i AKAFPK-së (përgjegjësi i sektorit të AFTI) për parandalimin e konfliktit të interesave në institucionet publike ka raportuar periodikisht pranë ILDKPKI dhe ka dorëzuar për titullarët e AKAFPK-së formularët e plotësuar të deklaramit të interesave private të tyre.
18. AKAFPK në bashkëpunim me MFE dhe SHKP ka inspektuar objektet shkollore mbi përmbushjen ose jo të standardeve normative nga ana e objektet shkollore, që aplikojnë për licencim pranë QKB-së. Lidhur me sa më lart, 1 përfaqësues i sektorit si pjesë e Grupit të inspektimit ka kontribuar në inspektimin e 3 objekteve shkollore.